Informacion në Albanian

Konsultim për të ardhmen e shkollës së mesme katolike La Sainte Union Catholic Secondary School

Camden është një vend i shkëlqyer për të mësuar dhe ne jemi krenarë për shkollat tona të jashtëzakonshme dhe personelin e tyre, i cili punon me përkushtim çdo ditë për t'u ofruar fëmijëve arsimimin më të mirë të mundshëm.

Ne dëshirojmë që çdo fëmijë në Camden të ketë një vend në një shkollë pranë vendbanimit të tij, e cila i përshtatet nevojave të tij dhe i ofron mjedisin më të mirë të mundshëm për të mësuar, për të krijuar miqësi dhe për t'u zhvilluar e përparuar.

Shkollat në Camden dhe në të gjithë Londrën po përballen me vështirësi financiare gjithnjë e më të mëdha.

Rënia e nivelit të lindjeve dhe shpërngulja e familjeve nga Londra kanë sjellë uljen e numrit të fëmijëve që regjistrohen në shkolla, duke çuar në uljen e numrit të nxënësve dhe në shtimin e vendeve të lira në shkolla.

Çdo vend i paplotësuar do të thotë se shkollat fillore humbasin mesatarisht 7 500 paund në vit nga fondet jetike të qeverisë, ndërsa shkollat e mesme humbasin mesatarisht 9 700 paund në vit.

Si këshill bashkiak, ne kemi detyrimin të sigurojmë një numër të mjaftueshëm vendesh në shkolla, që ofrojnë arsim cilësor dhe janë të qëndrueshme në planin afatgjatë, si dhe t'i administrojmë këto vende në mënyrë efikase.

Për shkak të rënies së numrit të nxënësve, duhet ta menaxhojmë këtë situatë duke bashkëpunuar ngushtë me shkollat.

Gjatë vitit të kaluar, në kuadër të Programit tonë për Sigurimin e Vendeve të Mjaftueshme në Shkolla, kemi bashkëpunuar ngushtë me shkollat që janë prekur veçanërisht nga këto problematika, duke u ofruar mbështetje në përballimin e këtyre vështirësive.

Pavarësisht përkushtimit të të gjithëve, **La Sainte Union Catholic Secondary School** është një nga katër shkollat që vazhdojnë të përballen me presionet më të mëdha dhe të vazhdueshme, duke përfshirë:

- numër të lartë vendesh të lira për nxënës
- presion financiar në rritje

Më 12 tetor 2026, publikuam një raport në të cilin rekomandohej zhvillimi i një procesi konsultimi për të ardhmen e shkollës **La Sainte Union Catholic Secondary School.** Më 20 tetor 2026, anëtarët e Kabinetit të Camden-it – grupi i drejtuesve nga këshilli bashkiak – u mblodhën dhe vendosën të vijonin me procesin e konsultimit.

Procesi i konsultimit është tashmë i hapur për një periudhë prej gjashtë javësh, nga ora 09:00 e datës 2 nëntor deri në orën 09:00 të datës 14 dhjetor 2026 – prandaj ju ftojmë të shprehni mendimin tuaj.

- Çdokush mund ta plotësojë konsultimin nga interneti në adresën: **consultations.wearecamden.org/schools/lasainteunion**
- Nëse fëmija juaj është nxënës në **La Sainte Union Catholic Secondary School** dhe preferoni ta plotësoni formularin e konsultimit në letër, mund të merrni dhe ta dorëzoni një kopje të printuar në shkollë. Të gjithë personat e tjerë mund të dërgojnë një email në adresën: **lasainteunionconsultation@camden.gov.uk**
- Për të marrë një broshurë informuese për konsultimin në formatin EasyRead (një format me tekst të thjeshtuar dhe ilustrime) ose në gjuhë të tjera, dërgoni një email në adresën: **lasainteunionconsultation@camden.gov.uk**

Do të organizohen gjithashtu takime në internet dhe takime me pjesëmarrje fizike për prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve që ndjekin këtë shkollë. Informacione të mëtejshme do t'u komunikohen atyre drejtpërdrejt.

Konsultimet me ju do të jenë për alternativat e mëposhtme dhe do të ftoheni të propozoni ose të identifikoni alternativa të tjera.

- Ulja e numrit të vendeve të ofruara në shkollë nëpërmjet zvogëlimit të Numrit të Publikuar të Pranimeve (PAN, sipas akronimit në anglisht).
- Krijimi i një strukture të përbashkët drejtuese ndërmjet La Sainte Union Catholic Secondary School (Shkolla e Mesme Katolike La Sainte Union) dhe të paktën një shkolle tjetër të mesme, që do të thotë se këto shkolla do të kenë një organ të përbashkët drejtues.
- Mbyllja vetëm për klasat 7 deri në 11, DUKE ruajtur dhe riorganizuar njëkohësisht arsimin për nxënësit mbi 16 vjeç (klasat 12 deri në 13/14).
- Mbyllja e plotë e shkollës për të gjitha klasat, nga klasa 7 deri në klasën 13/14.

Përpara se të jepni mendimin tuaj në kuadër të procesit të konsultimit, ju rekomandojmë fuqimisht të lexoni paketën informuese të konsultimit, e cila shpjegon më hollësisht të dhënat për shkollën dhe secilën prej alternativave.

Gjatë procesit të konsultimit, do të mbledhim prova mbi ndikimin e secilës alternativë për secilën shkollë.

Këto të dhëna do të paraqiten në një raport dhe do të përdoren si bazë për përcaktimin e hapave të mëtejshëm që do të propozojmë, për të cilët anëtarët e Kabinetit do të marrin një vendim në shkurt 2027.

Për më shumë informacion

- Shkarkoni dhe lexoni dokumentin e konsultimit në adresën: **consultations.wearecamden.org/schools/lasainteunion**

- Përgjigjet për pyetjet, materialet në formatin EasyRead (një format me tekst të thjeshtuar dhe ilustrime) dhe informacionet në gjuhë të tjera mund t'i gjeni në adresën: **camden.gov.uk/SchoolConsultations**
- Pyetjet tuaja mund t'i dërgoni në adresën e emailit: **lasainteunionconsultation@camden.gov.uk**

Hapat e mëtejshëm të parashikuar pas përfundimit të konsultimit gjashtëjavor:

- **Shkurt 2027:** Anëtarët e Kabinetit do të shqyrtojnë rezultatet e konsultimit, së bashku me faktorë të tjerë, dhe do të vlerësojnë se cila alternativë duhet të çohet përpara për secilën shkollë.
- **Shkurt 2027:** Nëse anëtarët e Kabinetit vendosin të paraqesin një propozim për bashkimin ose mbylljen e një shkolle, do të pasojë një periudhë konsultimi prej 4 javësh, e përcaktuar me ligj, gjatë së cilës shkolla, prindërit, kujdestarët dhe palët e tjera të interesuara mund të komentojnë sërish mbi propozimin.
- **Prill 2027:** Kabineti do të marrë vendimin përfundimtar për çdo propozim të paraqitur.
- **Prill–maj 2027:** Nëse vendimi ka ndikim ndaj personelit të shkollës, do të nisë një proces formal konsultimi për personelin e shkollës.
- **Data e zbatimit:** Kjo do të varet nga ndryshimet për të cilat do të bihet dakord, nëse do të ketë të tilla – por ndryshimet mund të fillojnë të zbatohen nga viti i ardhshëm shkollor (shtator 2027).

E kuptojmë se ky është një lajm i vështirë për t'u pranuar, por duhet të veprojmë tani për të parandaluar përkeqësimin e situatës dhe për të ruajtur mundësitë e mira arsimore që ofrojmë për të gjithë fëmijët në të gjithë territorin e bashkisë, si tani ashtu edhe në të ardhmen.

Gjithashtu, e kuptojmë se kjo është një periudhë që ju shkakton pasiguri dhe shqetësim. Ende nuk është marrë asnjë vendim dhe ne do të vazhdojmë t'ju mbajmë të informuar për çdo zhvillim.